

FAMILJE DINJITOZE NË KOSOVË DHE NË DIASPORË

Duke bashkëpunuar në një punim monografik, si bashkautore te **Pedagogjia: Shkolla Shqipe me Program Plotësues** etj., mësova disa të dhëna konkrete për familjen e njërit nga mësuesit e shquar të shkollave shqipe në diasporë, Mag.Hazir Mehmeti. Mësova për familjen e tij të ngushtë dhe të gjerë, me rrënjë të forta në traditën e pastër shqiptare, me kahje në integrimin europian, në nivele dhe modele shembullore, me standarde bashkëkohore shqiptare dhe europiane në të gjitha pikëpamjet. Ky model i emancipimit shoqëror, më krijoi ndjesi të veçanta respekti dhe admirimi. Kështu, më lindi dëshira t'ua bëj të njohur këtë familje dinjitoze, në dimension të gjerë dhe të drejtpërdrejtë, që përbën nder jo vetëm për ata vetë, por për shqiptarët e të gjithë hapësirës shqiptare dhe më gjerë.

Besoj që çdo lexues ndjen kënaqësi kur lexon e mëson të reja për një familje të varfër, dje si e gjithë masa e gjerë e fshatit dhe e qyteteve tona, por në dallim nga ato, sot ka kapur majat e familjeve europiane, jo ekonomikisht, por kryesisht në fushën e dijes e të profesioneve. Ka kapur majat duke bërë një jetë normale qytetare, por duke ruajtur njëkohësisht edhe trashëgiminë morale e kulturore kombëtare, ndonëse jetojnë e punojnë në Austri. Ata, me zemër janë në Kosovën e dashur dhe në mbarë viset shqiptare.

Kur lexon shënimet e Vlorës, vajzës doktore të shkencave në Austri, që deklaroi se "Jam e gatshme të kthehem në Kosovë", apo motrës së saj, Qamile Mehmetit, këshilltare në një kompani gjigande europiane, në RTKI, që deklaroi; "Jam krenare me familjen dhe rrethin tim", me nxitet më tej dëshira të hedh në letër këtë shkrim në organin e nderuar "Univers".

Hazir Mehmeti, është një nga mësuesit më të shquar, ndër rreth 600 mësues të shkollave shqipe në diasporë, mësues krijues, autor tekstesh mësimore, i vlerësuar dhe i trajtuar zyrtarisht nga pala austriake. Ai është pjesëtar nga më aktivët në hartimin e

teksteve shkollore ne gjuhën amtare, i nderuar me çmime te larta, si autor tekstesh aplikative dhe të traditës shqiptare në këtë fushë, me ndihmesa të çmuara intelektuale, sidomos në publicistikën social-pedagogjike, kulturore, letrare, studimore e botuese., Ai, së bashku me bashkëshorten e tij, zonjën e nderuar Nexhmije Mehmeti, janë tashmë shembull konkret i një familjeje për t'u admiruar, një model i vlerave më të mira të virtyteve morale shqiptare, me formim të gjerë bashkëkohor njëkohësisht.

Haziri, kryefamiljari actual, ka lindur, është rritur dhe edukuar në një mjedis familjar, në Drenicë të Kosovës, ku puna i ka karakterizuar të gjithë pjesëtarët e familjes bazë, e sidomos prindërit. Babai i Hazirit e kërkoi dhe e gjeti punën, si mjeshtër ndërtimi në Kosovë dhe here- herë edhe në zonat e tjera në ish - Jugosllavi, deri edhe në Kroaci e Slloveni. Gjyshja e Hazir Mehmetit, Qamilja, një grua e fortë dhe zonjë shtëpie, e kishte në gjak punën specifike për gratë e fshatit, por jo rrallëherë ajo bënte edhe punë burrash, duke qenë një model i virtyteve më karakteristike të moralit të shëndoshë, ku kishte vendin e vet edukata e punës, që rrezatonte edhe në familje. Kjo gjyshe e nderuar e Hazirit, Qamilja (Qama), apo Qamile Mehmeti, ishte motra e Rifat Bajskës, shok i afërt i Azem Galicës dhe familjes së tij. Ai, ishte hakmarrë ndaj masakruesve të familjes së Azemit, duke e kapur dhe ekzekutuar kryenaçanlikun serb në rrethin e Mitrovicës, veprim që e kreu bashkë me Shotën dhe shokët e tij. Qamilja ia kishte lidhur plagët Azem Bejtes, bashkë me Shotën, pas plagosjes së rëndë në luftimet e tij me pushtuesit serbë në fundin e vitit 1924, plagë nga të cilat ndërroi jetë. I kishte ruajtur për tridhjetë vite xhamadanin me gajtane të gjakosur të kryetrimt Azem Galica, pa e ditur askush. Nëna trime, para se të vdiste, në vitin 1975, kishte thënë se “nëse nuk i mbylleshin sytë kur të vdiste, do të ishte nga malli për dy vëllezërit: Rifatin dhe Hamitin”, që jetonin në Fier, të cilët që nga viti 1944 nuk i pa kurrë.

Haziri ishte rritur me tregimet e gjyshes, një trimëreshë dhe burrëreshë e vërtetë.

Familja e Hazir Mehmetit, me rrënjët e jëten e saj në Drenicë, nga babai Ramadani dhe nëna, Hamide Xani nga fshati Polac, e cila në personalitetin e saj mbartte formimin nga një familje e shëndetshme.. Nëna e Hazirit, Hamidja, përveç punëve të

zakonshme të një gruaje në fshat, që do të rriste dhe edukonte fëmijët e saj, kryente edhe punë të tjera, si çdo grua në fshatin e asaj kohe, përballonte edhe punë artizanale prej duarve të arta që kishte edhe në punime qëndisje, pëlhure, qilimi, kostume popullore etj. Ajo punonte me cilësi të lartë dhe kjo ishte edhe një tjetër ndihmë materiale dhe estetike për shtëpinë, në rrethanat e asaj kohe të vështirë.

Babai i Hazirit, Ramadani, njeri i urtë, i sinqertë, mirëpritës e krenar, i respektonte të gjithë dhe gëzonte gjithashtu respektin e të gjithëve. Ai punoi si bujk në fshat e më vonë edhe si murator në disa rajone të ish- Jugosllavisë, më shumë në Slloveni. Ishte autodidakt dhe shkruante bukur në gjuhën shqipe. E donte shumë shkollimin e fëmijëve. Haziri që i pari në fshat që kreu shkollën e mesme, Normalen në Mitrovicë, dhe Universitetin në Prishtinë. Motra e tij, Sabrija, ishte e para në fshat që kreu shkollën e mesme dhe shkollën e lartë komerciale në Pejë. Kjo ishte një thyerje e paragjytimeve të vjetra, një sfidë për kohën në Malësinë e Drenicës.

Haziri iu kundërvu veprimtarisë serbe, që donte të dobësonte e të zhdukte vetë ekzistencën shqiptare,, duke e shtrembëruar vlerat tona kombëtare, duke kufizuar arsimin shqip për të realizuar strategjinë për serbizimin e vendit. Prandaj,, u zgjodh nga masa e mësuesve në drejtim të organizmave arsimore, mori pjesë shumë aktive në funksionimin e shkollave në shtëpi, duke braktisur sistemin arsimor serb., Për këtë qëndrim e ndoqën dhe e bënë objekt persekutimesh para nxënësve, familjes, deri sa i dogjën edhe shtëpinë, duke e detyruar të marrë rrugën e emigrimit, përpara një burgimi të egër e të sigurtë. Jetoj shpirtërisht e aktivisht në organizmat në ndihmë të gjithanshme ndaj Kosovës gjatë viteve të luftës.

Mbi këtë bazë, edhe Haziri krijoi familjen e tij të re me zonjën Nexhmije Delia, nga fshati Isbicë i Drenicës, një zonjë sa punëtore aq edhe fisnike, edukatore natyrore e fëmijëve të saj, përkrah bashkëshortit.. Kështu, në këtë frymë, u rritën edhe fëmijët e tyre, të edukuar e me kulturë. Vajza e madhe, Albana, ishte nxënëse e shkëlqyer, mbaroi shkollën për edukatore dhe tani punon mësuese çerdheje në Grac të Austrisë.

Puna dhe studimi e kanë karakterizuar familjen e re të Hazir Mehmetit, si në Kosovë, ashtu edhe në emigrimin e tyre në Austri. Edhe kjo vatër e re, megjithëse formalisht e shkëputur nga familja e madhe, u lind dhe u rrit e shëndetshme, si pjesë e atij tringu familjar të shëndoshë, nga i cili kanë dalë e do të dalin pjesëtarë të tjerë në familje, të cilët do të mbështeten në të gjitha pikëpamjet tradicionale dhe bashkëkohore, shqiptare dhe evropiane njëkohësisht.

Këto e bënë Hazirin, bashkëshorten e tij, zonjën Nexhmije, si edhe vajzat e djemtë, që tashmë kanë dalë në jetë, në të gjitha pikëpamjet krenarë dhe modestë njëkohësisht për arritjet e larta, jo vetëm në punët e vlerata e të nderuara që kryejnë pas shkollimit të tyre dinjitoz, por edhe për virtytet e larta morale të familjes shqiptare e austriake që ata bartin.

Puna dhe studimi i pandërprerë ndër vite e ka formuar personalitetin e Hazirit nëpërmjet një kompleksi ngarkesash në Kosovë, e më pas në Austri, që i ka përballuar me dinjitet. Këto punë, jo gjithnjë ia kanë ngarkuar, por pa mbajtur qëndrim pritës, disa aspekte i ka kërkuar me bindje dhe këmbëngulje të fortë për t'i kryer. Dhe ia ka arritur gjithnjë. Kjo e ka bërë më të besueshëm edhe te të tjerët, që i kanë ofruar punën. Puna i ka siguruar edhe të ardhura për të mbajtur familjen, për të siguruar një mirëqenie, rritur,, edukuar dhe shkolluar fëmijët. Ndodh jo rrallë që kontradiktat ekonomike, çojnë edhe në konflikte familjare, por jo tek Haziri bashkë me bashkëshorten Ata kishin përballuar një "mori shtrëngatash e stuhish", se jeta nuk kishte qenë fushë me lule, por ata gjithnjë ia dolën në krye. Përsëri në punë të përbashkët siguruan ruajtjen dhe zhvilluan familjen e shëndetshme, një vatër model tashmë edhe për fëmijët,, duke i rritur dhe edukuar me standarte tradicionale dhe evropiane. , Të gjashtë fëmijët, i nxjorën suksesshëm në jetë, si familje e mirëorganizuar, ku padyshim ka rolin e vet të rëndësishëm Nexhmija, sepse siç thoshte Sami Frashëri në veprën e tij **Gratë**: "Familje, do të thotë grua".

Vlora Mehmeti, njëra nga vajzat, është magjistre në Universitetin e Vjenës dhe ka mbaruar studimet universitare për farmaci, kurse temën për doktor shkencash e ka përfunduar. Vlora e ka kryer temën e magjistraturës në Tokio, në gjuhën angleze, te profesori i njohur Asakaëa Yoshinori. Me hulumtimet

e saj është paraqitur si përfaqësuese e Universitetit të Vjenës nga grupi i shkencëtarëve të rinj në disa kongrese ndërkombëtare të hulumtuesve të rinj, si në Itali, Suedi, SHBA, Shqipëri, Maqedoni etj. Punimet e saj shkencore i janë botuar në revista të njohura shkencore në Evropë e më gjerë.

Vajza tjetër, Qamilja, ka mbaruar në Universitetin e Vjenës magistraturën e menaxhimit të ndërmarrjeve dhe është eksperte e disa programeve menaxheriale shumë të kërkuara. Ajo mban ligjërata në anglisht dhe gjermanisht para ekspertëve të firmave gjigande në Zyrih, Hamburg, Frankfurt, Berlin, Shtutgard, Vjenë. Punon te firma “Mercedes”, si menaxhere e vlerësuar nga stafi i firmës së njohur gjermane. Pritet të doktorojë së shpejti.

Besniku, djali, ka mbaruar për automekanik, duke qenë nxënës shumë i mirë në matematikë, ku fiton vendin e dytë në garat për matematikë në drejtimin automekanik të landit të Vjenës dhe merr shpërblim dhe mirënjohjen nga kryebashkiaku i Vjenës, Michael Haupl. Besarta, vajza e vogël, ka mbaruar për frizurë. Djali i dytë, Kreshniku, ka mbaruar studimet e larta në Universitetin e Vjenës në dy drejtime: Shkencat Politike dhe Zhvillimi Europian. Ai tani është ngarkuar e po zhvillon praktikën për diplomaci pranë ambasadës së Austrisë në Tiranë.

Puna e Hazirit si mësues, marrëdhëniet e mira me nxënësit e tij, përkushtimi ndaj tyre, madje edhe me inovacione profesionale, studimore dhe botuese, të vlerësuara nga pala austriake e më gjerë edhe me çmime ndërkombëtare, për tekstet shkollore në gjuhën amtare, për krijimtarinë letrare, e shoqëruar me botime të pandërprera, veprimtaritë sociale, ia afirmuan gjithnjë e më shumë personalitetin. Ai është anëtar i disa redaksive, brenda dhe jashtë Austrisë e më gjerë, si dhe është pranuar anëtar i Akademisë së Shkencave të Edukimit në Shqipëri, për veprat dhe shkrimet studimore që ka bërë e vazhdon të shkruajë e të botojë në fushën e edukimit.

Bashkëshortja, Nexhmija besnike, i qëndroi Hazirit në krah, në çdo situatë, duke i krijuar kushte edhe për punën e tij me vizion të gjerë. Të dy së bashku, bënë edhe prindërimin shembullor dhe mbajtjen e shtëpisë në rrethana të reja. Së bashku, si dy kolona të fuqishme të familjes, u kujdesën dhe vazhdojnë edhe sot të kujdesen, pasi si prindër ata e përjetojnë çdo veprim të vajzave

dhe të djemve, siç gëzohen edhe për emrin e mirë, që kanë fituar fëmijët, duke e justifikuar plotësisht kujdesin e prindërve. Zonja Nexhmije është marrë e merret me vajzat, jo si tutore, por si nënë që respekton personalitetin e sejcilës, sipas natyrës dhe veçorive, që nga fëmijëria, adoleshenca dhe tani, duke u treguar sa bashkëkohore, por edhe shqiptare evropiane njëkohësisht. Ajo ka vepruar në respekt të traditës dhe të pozitës së vajzave të shkolluara, duke bërë të njohura edhe disa përvoja jetësore, pa harruar që është në zemër të Europës, në Vjenë. Vajzat kanë të drejtë të jenë krenare për babain e tyre të nderuar e të dashur, ashtu edhe për nënën e tyre, siç janë krenarë edhe prindërit për vajzat e djemtë e tyre. Investimi në familje, falë Zotit dhe kujdesit prindëror, është bërë në kohën dhe në vendin e duhur.

Haziri i ka vlerësuar gjithnjë punët e ngarkuara, edhe kur emigroi në Austri me statusin e emigrantit politik, kur fillimisht bëri edhe punë të rënda fizike, edhe kur ndiqte kurset e gjuhës së vendit pritës, edhe kur ndiqte kualifikimet e tjera, edhe kur u përgatit për konkursin për vendin e mësuesit të shkollave shqipe, pasi u paraqitën 20 kandidatura, dhe fituan tre vetë, përfshirë edhe Hazirin. Edhe në arsim me përkushtim të veçantë, përballoi kërkesat, që në Austri nuk ishin të lehta. Siguroi parakushtet e të mësuarit për vajzat dhe djemtë, pa folur për detyrimet imediate. Ai u frymëzua nga modeli i punës në shtëpi, modeli i babait dhe nënës, të cilët me harmoninë dhe sakrificat e tyre, që nuk ishin të pakta, arritën t'i edukojnë, t'i arsimojnë fëmijët në nivele universitare dhe pasuniversitare. "Unë dhe shoqja ime prodhuam lule të mrekullueshme, - shkruan Haziri, për vajzat e tij dhe djemtë.

Tashmë, familja shqiptare që njihet dhe respekton traditën shqiptare dhe evropiane njëkohësisht, gradualisht, sipas ligjeve të natyrës, pa u nxituar, përgatitet për ndryshime dhe është në pritje të nipave e mbesave... Zoti i bekoftë! Shëndet e lumturi familjare dhe në jetë! Lotët e përcjelljes së vajzave, djalit e mbesave, nipave, tani e në të ardhmen në fatin e tyre, ardhshin shpejt e në kohë edhe me lotë gëzimi të tjera për prindërit e nderuar!

Brezi nga brezi ka ndryshimet e veta. Por, prindërit kanë edhe të përbashkëtat e tyre në raport me vajzat dhe djemtë.

Puna e Hazirit është një vazhdim i punës së babait të tij, që ka punuar me dinjitet si mjeshtër në ndërtim në Europë dhe e nënës,

që ka ruajtur dinjitetin e barrën e rëndë të dy prindërve së bashku, në shume raste njëkohësisht. Një vazhdimësi në situata të reja i prindërve shembullorë Hazir dhe Nexhmije, një model familjeje të shëndetshme, që ka kapërcyer vështirësi të shumta, duke ruajtur themelet e shëndosha të familjes, përvojë dhe model i transmetuar te pasardhësit si dje, ashtu edhe sot, çka në optikën tonë, përbëjnë modele jo për shabllonizëm, por për mjeshtëri, përkushtim e vlerësim të të gjithë faktorëve që e çojnë familjen në shkallën e lartë të përcaktimit, “familje e shëndetshme” në kuptimin më të plotë të këtij koncepti. Pra, një edukim i shëndetshëm që përsëritet në breza. Nëna, është emri më i shtrenjtë, themeli i familjes së shëndetshme, por që mbështetet fuqishëmnë kolosin e shtëpisë, familjes, shoqërisë, Hazir Mehmetin.

Burimet:

- Kraja, Emirjona. **Mësuesi krijues.** Monografi social-pedagogjike, Tiranë, 2016, fq. 206-207
- Kraja, Musa. **Pedagogjia, Shkolla Shqipe me Program Plotësues,** Tiranë, 2013.
- Mehmeti, Hazir. **Arsimi shqip në Austri 1987-2012,** Prishtinë, 2013.
- ALBANELLU. Revista “*Shqiptari*”, Bukuresht, nr, 11, 2014.
- Shatri, Bajram. **Arsimi shqip në Kosovë, 1990-1999.**
- Tahiri, Bedri. **Azem Bejte Galica.** Prishtinë, 2005.
- Mehmeti, Hazir.: **Abetare shqipe në Austri.** Prishtinë, 2013.
- Kraja, Musa. **Sa merresh me fëmijën tënd?** Tiranë, 2008.